



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I47-5 Prot.
Nr. Doc.202502835/5

Tiranë 13/06/2025

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në drejtim të trajtimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshirë femicidin.*

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
TIRANË**

Të nderuar,

Avokati i Popullit, si një institucion i pavaruar, në ushtrimin e funksioneve të tij sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, tregon kujdes të veçantë lidhur me promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë dhe të drejtat e grave dhe vajzave, si pjesë e pandashme e të drejtave të njeriut.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe dhuna në familje me të gjitha format e saj, përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe cënojnë rëndë dinjitetin, shëndetin dhe të drejtën e jetës, të drejta këto të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe një sërë dokumentesh ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Vrasja e grave dhe vajzave është forma më ekstreme e dhunës me bazë gjinore dhe kjo formë e rëndë ka shënuar rritje vit pas viti, si në rang global ashtu edhe në Shqipëri¹.

Që prej vitit 2013, Këshilli Social Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, duke e konsideruar vrasjet e grave dhe vajzave/femicidet si alarmante për shkak të rritjes së numrit të tyre në rang global, nëpërmjet Deklaratës së Vjenës mbi Femicidin², i ka nxitur Shtetet Anëtare: *“Të ndërmarrin masa në lidhje me detyrimin e tyre të kujdesit të duhur për të mbrojtur gratë si dhe për të parandaluar dhe ndjekur penalisht femicidet, për të ndërmarrë iniciativa institucionale për përmirësimin e parandalimit të femicideve dhe sigurimin e mbrojtjes ligjore me mjete juridike dhe dëmshpërblimin e grave të mbijetuara të dhunës ndaj grave, në përputhje me traktatet ndërkombëtare dhe të shqyrtojnë miratimin dhe zbatimin e legjislacionit për të hetuar, ndjekur penalisht, ndëshkuar dhe korrigjuar femicidin në përputhje me përvorjat efektive të disa vendeve.”*

Avokati i Popullit, ka ngritur Observatorin për Femicidet në Shqipëri³, që prej muajit mars të vitit 2024. Observatori për Femicidet është një mekanizëm monitorimi lidhur me vrasjet e grave/vajzave, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni dhe fuqizimin e mekanizmit për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës gra/vajza.

Nëpërmjet Observatorit për Femicidet mblidhen të dhëna në nivel kombëtar, të cilat i nënshtrohen një analize të thellë, që shërben për identifikimin e boshllëqeve në zinxhirin e mekanizmit mbrojtës për viktimat e dhunës, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës së dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të raporteve vjetore.

¹ Norma e femicidit në Shqipëri për vitin 2021 ishte 0,85 për 100,000 popullatë gra dhe vajza; në vitin 2022 kjo normë ra në 0,50 dhe në vitin 2023 u rrit në 0,84. Krahasimi me disa nga vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian për vitet 2021, 2022 dhe 2023 tregon se:

- Në 2021, norma e femicidit në Shqipëri ishte më e lartë se në Maqedoninë e Veriut, Itali, Slloveni, Serbi, Maltë, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Çeki, Bullgari, Rumani, Greqi, Hungari dhe në Mal të Zi.
- Në 2022, norma e femicidit në Shqipëri ishte më e ulët se në disa prej këtyre vendeve dhe më e lartë se në Slloveni, Maqedoninë e Veriut dhe Itali.
- Në 2023, norma e femicidit në Shqipëri ishte më e ulët krahasuar me Maqedoninë e Veriut, por më e lartë se në të gjitha vendet e tjera të përzgjedhura për krahasim.

²Deklarata e Vjenës mbi Femicidet,

https://www.unodc.org/documents/commissions/CCPCJ/CCPCJ_Sessions/CCPCJ_22/_E-CN15-2013-NGO1/E-CN15-2013-NGO1_E.pdf

³Observatori për Femicidet është ngritur në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komiteti i Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit etj, për mbledhjen, publikimin dhe analizimin e të dhënave për vrasjet e grave dhe vajzave në nivel kombëtar. Ky Observator mbështetet nga Programi i Përbashkët të Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë Shqiptare “T’i japim fund dhunës ndaj Grave”, i financuar nga Qeveria e Suedisë.

Bazuar në analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2024 në kuadër të Observatorit, Avokati i Popullit ka hartuar Raportin “Vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri, 2021-2023.”⁴

Gjejmë rastin të falenderojmë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit në dhënien e informacionit të kërkuar në kuadër të përgatitjes së këtij raporti.

Raporti “Vrasjet e grave dhe vajzave- femicidi në Shqipëri” (2021-2023), u prezantua gjatë Konferencës Vjetore të Avokatit të Popullit, me titull “Femicidi- Problemi social përtej statistikave”, organizuar më datë 10 dhjetor 2024, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe në përfundim të 16 ditëve të Aktivizmit kundër dhunës ndaj grave. Në këtë konferencë pati një pjesmarrje të gjerë të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë, institucioneve shtetërore përgjegjëse që trajtojnë çështjet e dhunës ndaj grave, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare.

Sipas raportit gjatë viteve 2021-2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajza, nga të cilat 24 u vlerësuan si femicide, ose vrasje për shkak të gjinisë bazuar në kuadrin statistikor të OKB.

Sipas kuadrit statistikor të OKB, për qëllime të mbledhjes së të dhënave dhe prodhimit të statistikave, vrasjet e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë ose Femicidet përkufizohen si: “Vrasje me dashje të grave/vajzave të kryera nga partnerë intimë, nga anëtarë të tjerë të familjes dhe ato të kryera nga persona të tjerë bazuar në mënyrën e kryerjes ose në kontekste të veçanta treguese të motiveve gjinore”.

Të dhëna të tjera treguan se 27 gra/vajza u vranë nga autorë me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare. Nga 28 autorët e vrasjeve, 26 ishin burra/djem dhe në dy raste autore ishin një grua dhe një vajzë. Në 28 raste autori është gjetur dhe në dy raste autori nuk është gjetur nga organet kompetente. Gjashtë autorë humbën jetën menjëherë pas ngjarjes, nga të cilët pesë u vetëvranë dhe një humbi jetën në përpjekje për t’iu shmangur arrestimit nga policia. Dy autorë humbën jetën në paraburgim gjatë hetimeve.

Rezulton se në rreth 90% të rasteve viktimat dhunoheshin nga autorët e vrasjes përpara kryerjes së krimit, por vetëm 6 prej tyre (25%) e kishin raportuar më parë në polici dhunën, dy prej këtyre rasteve ishin të pajisura me masa mbrojtëse (UMM/UM) në momentin e vrasjes, asnjë prej rasteve nuk ishte pajisur me Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

⁴Shih Raportin në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

Avokati i Popullit, bazuar në gjetjet e këtij raporti dhe në praktika të vendeve të tjera evropiane, të cilat kanë ngritur Observatorin për femicidet, do të vijojë punën për përgatitjen e raportit vjetor për vitin 2024. Objekt shqyrtimi dhe monitorimi në kuadër të këtij raporti, përveç vrasjes së grave dhe vajzave/femicidit, do të jenë edhe vrasjet e grave dhe vajzave të mbetura në tentativë, plagosjet e rënda me dashje (neni 88 i Kodit Penal) dhe shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99 i Kodit Penal) të ndodhura gjatë vitit 2024. Për këtë qëllim, bashkëpunimi me MSHMS/Operatorin e Kujdesit Shëndetësor po vijon edhe gjatë vitit 2025.

Avokati i Popullit vlerëson se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) luan një rol kyç dhe të shumëfishtë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore përfshirë dhunën në familje, duke siguruar mbështetje sociale, shëndetësore dhe psikologjike për viktimat.

MSHMS është autoriteti kryesor përgjegjës sa i përket hartimit të strategjive dhe programeve në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sipas Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është parashikuar mbështetja dhe mbikëqyrja e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare nga ana e kësaj ministrie.

Avokati i Popullit vazhdon të konstatojë se programet e rehabilitimit për dhunuesit janë ende të kufizuara dhe kanë mungesë të trajtimit të varësive nga drogat, alkooli si dhe të problematikave të shëndetit mendor. Shërbimi për rehabilitimin e dhunuesve ofrohet vetëm në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë nga Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem dhe Qendra “Vatra”.

Sipas raportit të Avokatit të Popullit rezulton se nga 28 autorë, 4 prej tyre kishin probleme të shëndetit mendor dhe 8 autorë ishin përdorues të alkoolit dhe drogës. Duke konsideruar numrin e lartë të autorëve me problematika të tilla (43% e rasteve), del si nevojë urgjente ashtu siç është theksuar edhe në rekomandime të mëparshme të Avokatit të Popullit, ngritja e qendrave/programeve rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ, pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.

Fryma e legjislacionit kundër dhunës në familje synon ofrimin e një shërbimi të shpejtë dhe të thjeshtë nga institucioni përgjegjës më i afërt, përfshirë institucionet shëndetësore, policinë, njësitë vendore dhe gjykatat.

Në këtë kuadër, institucionet shëndetësore kanë detyrimin të ofrojnë ndihmë mjekësore, sociale dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Ato duhet të evidentojnë çdo rast dhune në dokumentacionin e posaçëm mjekësor dhe të pajisin viktimat me raportet mjekësore përkatëse.

Sipas raportit rezulton se institucionet shëndetësore nuk kishin trajtuar asnjë nga viktimat që më parë kishin raportuar në polici, në përputhje me procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Nga të dhënat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor bazuar në raportet e Drejtorive Rajonale të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë⁵, rezulton se përgjatë viteve 2021-2023, vetëm 28 raste të dhunës në familje, janë trajtuar nga institucionet shëndetësore. Ky numër konsiderohet shumë i ulët në raport me numrin e raportimeve të dhunës në nivel kombëtar.

Një problematikë tjetër mbetet trajtimi i fëmijëve të prekur nga femicidi dhe dhuna. Sipas raportit, 35 fëmijë u prekën nga vrasja e nënave të tyre, nga të cilët 20 ishin të mitur, për më tepër, disa prej tyre ishin të pranishëm në momentin e ngjarjes. Këta fëmijë vuajnë pasojat psikologjike, por edhe ekonomike, për shkak të ngjarjes edhe të zgjatjes së procedurave gjyqësore mbi kujdestarinë.

Në lidhje me shërbime mbështetëse për fëmijët e viktimave të dhunës në familje dhe femicidit, rezulton se efikasiteti i këtyre shërbimeve ndikohet nga disa sfida, si: mungesa e burimeve të specializuara, kapaciteteve të limituara dhe shpesh mungesa e mbulimit të gjerë rajonal.

Shërbimet ekzistuese shpesh janë të përqendruara në zonat urbane dhe nuk arrijnë gjithmonë të përmbushin nevojat specifike të fëmijëve që kanë përjetuar trauma të thella psikologjike si pasojë e dhunës ose humbjes së prindit nga femicidi.

Për më tepër, nevojitet një përmirësim i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe integrimi më i madh i shërbimeve sociale, psikologjike dhe edukative për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për këta fëmijë. Pra, ndërsa MSHMS ofron një bazë shërbimesh, ekziston nevoja për fuqizim dhe zgjerim të tyre për t'u garantuar fëmijëve një mbrojtje dhe ndihmë më efikase dhe të përshtatur.

Në lidhje me mbështetjen me ndihmë financiare rezulton se për shkak të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, sidomos në gjykatat e mëdha të

⁵Shkresa Nr. 2632/1 prot., datë 01.08.2024 e OSHKSH.

vendit, kjo mbështetje ofrohet për familjet kujdestare të fëmijëve pas një periudhe kohore që shkon mbi 1 vit.

Kjo vonesë i vendos familjarët në vështirësi të mëdha, duke rritur nevojën për mbështetje emergjente financiare dhe materiale.

Në këto kushte lind nevoja e krijimit të një fondi social për mundësimin e mbështetjes financiare dhe materiale për fëmijët e prekur nga femicidi me qëllim mbështetjen e menjëhershme dhe në përputhje me nevojat e tyre.

Avokati i Popullit më herët ka adresuar edhe një sërë rekomandimesh përmes Raportit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020 - shtator 2021”⁶, nga ku ka rezultuar se një pjesë e tyre mbeten ende të parealizuar.

Në raportet e CEDAW⁷ dhe GREVIO⁸ për Shqipërinë, rekomandimet kyçe për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) përfshijnë:

- MSHMS të sigurojë shërbime të specializuara dhe mbështetje për viktimat e dhunës, përfshirë këtu shërbime psikologjike, mjekësore dhe ligjore.

- Stafi mjekësor dhe shëndetësor të trajnohet për të identifikuar dhe trajtuar rastet e dhunës ndaj grave dhe për të ofruar mbështetje të duhur për viktimat, si dhe për të ndihmuar në trajtimin e pasojave të dhunës.

- Koordinim më të ngushtë ndërmjet MSHMS dhe institucioneve të tjera për të ofruar një sistem të integruar mbështetjeje dhe mbrojtjeje për viktimat e dhunës.

Këto rekomandime synojnë forcimin e kapaciteteve të MSHMS për të trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës, duke siguruar një përgjigje më të shpejtë dhe të koordinuar ndaj këtij fenomeni.

Bazuar në konstatimet e Observatorit për Femicidet, rekomandimet e mëparshme të dhëna nga Avokati i Popullit, të cilat mbeten ende të paadresuara, duke vlerësuar rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti kryesor përgjegjës sa i përket hartimit të strategjive dhe programeve në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2023, rekomandimet e Komitetit CEDAW dhe GREVIO⁸, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe

⁶Shih raportin e plotë në linkun : <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

⁷Komiteti i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, raporti “Vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin e pestë periodic të Shqipërisë”, viti 2023, shih: <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n23/352/80/pdf/n2335280.pdf>

⁸Raporti i parë i vlerësimit tematik për Shqipërinë i Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), “Ndërtimi i besimit duke ofruar mbështetje, mbrojtje dhe drejtësi”, shtator 2024.

lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDON:

Marrjen e masave për:

1. Përsheptimin e masave mbështetëse për rritjen e kapaciteteve të MKR-ve për të siguruar një funksionim sa me efektiv të të gjithë mekanizmave në 61 bashkitë e vendit, veçanërisht në drejtim të vlerësimit të riskut, monitorimit të urdhrave të mbrojtjes dhe përfshirjes së viktimave në programet mbështetëse;
2. Zhvillimin e trajnimeve dhe mbikëqyrjen e sektorit të shëndetësisë, i cili mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referimine rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore mbi çdo lëndim ose dëmtim, të nevojshme për t’u përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat;
3. Organizimin e vazhdueshëm të fushatave ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe femicidit si forma më e rëndë e dhunës (krahas fushatave të dedikuara botërore dhe me fonde publike);
4. Rritjen e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social, në nivel qarku dhe në bashkitë me numër të lartë rastesh si dhe rritjen e numrit të shërbimeve mbështetëse;
5. Ngritjen e qendrave/ programeve rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, të cilat të përfshijnë edhe trajtimin e varësisë nga droga, alkooli si dhe problemet e shëndetit mendor, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ, pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.
6. Marrjen e masave për krijimin e një fondi social për mundësimin e mbështetjes financiare dhe materiale për fëmijët e prekur nga femicidi me qëllim mbështetjen e menjëhershme dhe në përputhje me nevojat e tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

VILMA SHURDHA